

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Çdo gjë gati për “Marshin për Liri”
ADRESA	https://www.koha.net/arberi/cdo-gje-gati-per-marshin-per-liri
BURIMI	koha.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	13 shtator 2026, 19:46:51 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	12 shtator 2026, 10:05:32 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	2011f89b0305f06f4877316d7e40515d7ce5d2e1ef5727846de1640448848ed8
TEKSTI	6e96e2448b149b2af954deb97f87fa5e143dd62e01ca4d82c9f3970e095ba932
PAMJA	ce4d0091c4a5a1dfdb6fc0918f5ecbca5d94c4cc46efa96931245551dc577d4c

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	e79a8fc262acbc8ddd08c91dc30511066cfc3f834e9ee19c4ef53b48219c0a9d
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	965b786ec23a8b4bb286f1d277ec370fc2da1c7624603044806722a90083ae20
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

https://scan.stamles.eu/verify/e79a8fc262acbc8ddd08c91dc30511066cfc3f834e9ee19c4ef53b48219c0a9d

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Mbështete KOHËN. Ruaje të vërtetën

Kontribuo →

Letër lexuesit

ARBËRI

Çdo gjë gati për “Marshin për Liri”



12 shtator 2026 12:05

Shpërndaje në:



Klikoni këtu nëse dëshironi t'i lexoni lajmet e fundit dhe të përzgjedhura në kanalin tonë zyrtar në Viber

Pak orë para nisjes së “Marshit për Liri”, sheshi “Skënderbeu”, në Prishtinë ka nisur të marrë pamjen e një tubimi masiv në mbështetje të ish-krerëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, të cilët po gjykohej në Hagë.

Në shesh është duke u përgatitur skena ku do të mbahet programi i organizuar nga Platforma “Liria ka Emër”, ndërsa në qendër të kryeqytetit kanë filluar të mbledhen qytetarë nga vende të ndryshme.

Në disa pjesë të shesheve janë vendosur edhe tezgja ku shiten flamuj dhe simbole kombëtare.

Organizatorët kanë bërë të ditur se marshi “Kosova po Pret” do të nisë në orën 14:00, i cili po mbahet para shpalljes së verdiktit final të Gjykatës Speciale në Hagë ndaj ish-krerëve të UÇK-së.

Ismail Tasholli, organizator i Platformës “Liria ka Emër”, tha se përgatitjet janë drejt përfundimit dhe se Prishtina është gati të mirëpresë pjesëmarrësit nga mbarë Kosova.

Edhe



Arbëri • 12 sht 2026

Sot marshohet për liri

“Janë detaje shumë të vogla, po kryesorja është kry. Ka mbetë veç edhe një pikë e radhës. Krejt Kosova do të marrë në Prishtinë, Prishtina është gati. Prishtina e ka zemrën e madhe për secilin qytetar të saj, ka hapësirë për të gjithë. Hajde sa më herët, sa më mirë, se edhe nuk i bllokojmë rrugët. Kështu që çdo gjë është gati”, tha Tasholli.

Ai njoftoi se nisja e qytetarëve nga komunat e ndryshme ka filluar që nga ora 10:00, ndërsa organizimi i transportit është bërë në bashkëpunim me komunat.

Sipas tij, programi do të përfshijë edhe pjesëmarrjen e këngëtarëve Arif Vladi dhe Shkurte Fejza.

“Në përgjithësi nisja është nga ora 10:00, mandej varion nëpër

Futboll.

Taulant Hodaj me akuza të reja për rastin Rrahmani, FFK-ja nuk deklarohet

Futboll.

Dy gola e një asistim për Xherdan Shaqirin në Zvicër

Arbëri.

OVL e UÇK-së: BE-ja veç çka s'po thotë mos na pengoni t'i dënojmë krerët se në Apel i llojmë

Futboll.

Barcelona vazhdon me fitore

Futboll.

City në epërsi ndaj Unitedi, shënon Haaland

Shtojca për Kulturë.

“Bota serbe” deri te propaganda për fajësimin e viktimave

komuna të ndryshme. Komunitat faktikisht e kanë organizuar, ne jemi bashkërenduar me ta edhe i kanë oraret e tyre, orarin e pikës së takimit, grumbullimit edhe nisjes. Po, ka me pasë këngëtarë, po. Janë dy... është Arif Vladi dhe Shkurte Fejza dhe përmbyllet me Shkurte Fejzën marrë fjalën, po e lëmë për atëherë. Edhe të tjerat kemi me i pa se edhe pak orë na ndajnë... na ndajnë prej marshit të Lirisë së Kosovës... Ne presim që procesi të jetë i drejtë. Ne mendojmë që djemtë tanë do të vijnë sepse lufta jonë ka qenë e drejtë dhe ne shpresojmë që drejtësia do të triumfojë, tha ai.

Tasholli tha se pritshmëritë për pjesëmarrje janë të mëdha, duke e cilësuar marshin si një nga tubimet më masive deri më tani.

Në mesin e qytetarëve që kanë ardhur për të marrë pjesë në marsh është edhe Abdullah Aliu, ish-pjesëtar i UÇK-së, i cili ishte i veshur me uniformën e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Ai tha se kishte ardhur për të shprehur mbështetjen ndaj ish-krerëve të UÇK-së, duke kërkuar lirinë e tyre.

Edhe



Arbëri • 11 sht 2026

“Liria ka Emër” fton për pjesëmarrje në marsh, Kurti e Abdixhiku s’i përgjigjen ftesës për fjalim

“Emocionet janë të mëdha sot për këta burra, na ka çlirua vendin UÇK-ja. Patjetër janë të mbajtur padrejtësisht në Hagë, jo, gjykata është e padrejtë, e padrejtë. Për këta burra tonë, a po kupton? Me respekt për ta, i presim me zemër edhe në shtëpi... Po, duhet patjetër. Ka me u mbush sheshi sot për këta burra. Ne për këtë send kemi ardhur sot, edhe ata ushtarë që kanë shkuar në Hagë. E për këta burra me u mbajtur padrejtësisht në Hagë, katastrofë”, tha Lahu.

Ndërkaq, Hazir Selmani, i cili kishte ardhur nga Zvicra enkas për marshin, tha se pjesëmarrja e tij ishte në mbështetje të çlirimtarëve dhe në kërkim të drejtësisë.

“Enkas. Në mbështetje të çlirimtarëve tanë, në kërkim të drejtësisë dhe lirim të tyre. Uroj dhe shpresoj se drejtësia do të vijë nga ana e tyre dhe ata do t’i kthehen familjeve të tyre dhe vendit që kanë dhënë shumë për të. Është e papranueshme, të rrinë aty pa asnjë bazë, me ato akuza të kurdisura prej Serbisë, prej Rusisë. Çfarë mund të thuhet tjetër? Nga ’16-ta aty janë, të kthehen aty ku kanë lindur, këtu ku kanë lindur dhe kanë bërë shumë për ne”, deklaroi Selmani.

Ai tha se qytetarët duhet të vazhdojnë të mbështesin ish-krerët e UÇK-së edhe në rast të një vendimi të pafavorshëm.

“Patjetër, nuk duhet me u ndalur, me u dorëzuar asnjëherë. Nuk besoj që kjo do të ndodhë, por nëse ndodh, duhet me qenë të gjithë në anën e tyre. Organet e shtetit, institucionet e shtetit, kombi i shtetit, çdo shqiptar çfarë ka mundësi me bërë në mbrojtje të drejtësisë. Besoj që nuk do të ndodhë ajo, por nëse ndodh, duhet me vepruar mjaft. Për mua, ata që janë kundër e kenë parasysh se në çfarë gjendje jemi. Për mua është e papranueshme. Anti-kombëtare. Turp është. Nuk ka dashur me ndodhë se ne duhet t’i përkrahim ata, i njohim vetëm si çlirimtarë”, tha Selmani.

Edhe Bajram Zeqiri tha se pjesëmarrja në marsh ishte një mënyrë për t’u solidarizuar me ish-krerët e UÇK-së.

Edhe



Arbëri • 21 gus 2026

Katër ditë para vendimit të Speciales, marshohet nën moton “Kosova po pret”

“100%. 100% jam i bindur se do të lirohen se në qoftë se dënohen ata, dënohet krejt UÇK-ja dhe shteti i Kosovës. Edhe dënohet edhe NATO-ja me bombat e NATO ‘99-ës të Jugosllavisë e Amerika nuk e lejon këtë. S’janë të pafajshëm edhe pres që të ketë sa më shumë protestues. Jam i bindur që do të dalin protestues në Prishtinë deri në 200 mijë vetë... Do të marrin pjesë deri në 300 mijë shqiptarë protestues kundër... Do, qeveria duhet krejt ata me qenë këtu se këtu nuk ka parti. Kjo

është gjë popullore e gjithë kombit shqiptar. Nuk këqyret këtu partia apo individi, këtu është çështja kombëtare e kombëtare shqiptare”, tha Zeqiri.

Marshi “Kosova po Pret” do të nisë në orën 14:00 në Prishtinë, ndërsa organizatorët kanë bërë thirrje për pjesëmarrje masive të qytetarëve. /KP

LEXO PËR DITËSIMET TJERA



Mijëra qytetarë marshojnë në mbështetje të ish-udhëheqësve të UÇK-së

#MARSHI PËR LIRI

Artikuj të ngjashëm

Arbëri • 12 sht 2026

Kosova i kërkon Hagës lirim të çlirimtarëve

Arbëri • 12 sht 2026

“Liria ka Emër”: Në marsh morën pjesë rreth 100 mijë qytetarë

KOHA

Kjo faqe kontrollohet dhe menaxhohet nga KOHA. Të gjitha materialet në të, përfshirë fotografi, janë të mbrojtura me copyright të KOHA-s dhe për to KOHA mban të drejtat e rezervuara. Materialet në këtë faqe nuk mund të përdoren për qëllime komerciale. Ndalohet kopjimi, riprodhimi, publikimi i paautorizuar qoftë original apo i modifikuar në çfarëdo mënyre, pa lejen paraprake të KOHA-s. Shfrytëzimi i materialeve nga ndonjë faqe interneti a medium tjetër pa lejen e Grupit KOHA, në emër të krejt njëjësive që e përbejnë (Koha Ditore, KohaVision, Koha.net, Botimet KOHA, KOHA Print dhe ARTA), është shkelje e drejtave të autorit dhe të pronës intelektuale sipas dispozitave ligjore në fuqi. Të gjithë shkelësit e këtyre të drejtave do të ballafaqohen me ligjin.

Marketing

Politika e privatësisë

Kushtet e përdorimit

Udhëzime për përdorimin e IA-së

Cilësimet e privatësisë dhe cookies

Perkthimi i përmbajtjeve në gjuhët tjera bëhet në mënyrë automatike dhe mund të ketë gabime!

+383 (0) 38 249 105 /

AL EN DE FR ES GR SR TR MK

Aneksi i ish-Radio Prishtinës (kati i parë) Xhorxh Bush p.n., 10000 Prishtinë

Shkarkoje aplikacionin e KOHËS

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.